

Prokurori Publik i Qarkut
Nr. 83/2000
20 mars 2003 (aktakuza origjinale e ngritur
me 3 prill 2000)
Gjilan

GJYKATËS SË QARKUT NË GJILAN, për panelin gjykues

Në bazë të nenit 45, paragrafi 2, pika 3 në lidhje me nenin 337 të Ligjit të Procedurës Penale, parashtrojmë këtë

AKTAKUZË TË NDRYSHUAR

Kundër:

MOMCILO TRAJKOVIC, nga babai [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR], emri i vajzërisë [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR] në fshatin Carakovac, me banim të përhershëm në Kamenicë, [REDAKTUAR], Serb, i martuar, baba i tre fëmijëve, i diplomuar në shkollë të lartë, ka shërbyer shërbimin e rregullt ushtarak, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka dosje penale dhe aktualisht është në liri.

SEPSE

Me 27 qershor 1999, në Kamenicë rreth orës 1700, i akuzuari me qëllim për të vrarë dhe i motivuar nga urrejtja etnike dhe paragjykimi ka shtënë dhe ka qëlluar në A [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR] dhe M [REDAKTUAR] F [REDAKTUAR] derisa të dy palët e dëmtuara po vendosnin flamurin Shqiptar para ndërtesës së Departamentit të Punëve të Brendshme në Kamenicë në të njëjtin vend ku ishte ngritur flamuri Serb. I akuzuari kishte dalë nga ballkoni i banesës së tij i cili ishte përballë ndërtesës së Departamentit për Punë të Brendshme dhe kishte bërtitur se si ishte e mundur që terroristët Shqiptarë të vendosin flamurin aty. I akuzuari pastaj kishte shtënë drejt A [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR] dhe M [REDAKTUAR] F [REDAKTUAR] nga ballkoni i tij e pastaj edhe nga dhoma e banesës së tij. M [REDAKTUAR] F [REDAKTUAR] ishte qëlluar dhe ishte plagosur në këmbën e djathtë.

Përshtatshmërisht, ai kishte kryer dy pika të vrasjes në tentativa të definuar dhe sanksionuar sipas nenit 30, paragrafi 2 pika 3 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenin 19 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Në datë të panjohur ai fitoi armët e zjarrit dhe materialin eksploziv në vijim dhe i mbajti ato pa leje në banesën e tij në Kamenicë deri me 7 shtator 1999; një pushkë automatike AK-47, 300 plumba pushke dhe 2 granata dore, të cilat qytetarët nuk duhet ti kenë në posedim fare; policia ushtarake e KFOR-it konfiskoi të gjitha gjatë kontrollimit të banesës.

Përshtatshmërisht, i akuzuari ka kryer krimin e posedimit të paautorizuar të armëve apo materialit eksplozives sipas nenit 199, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës.

PROPOZIM

Propozohet që gjykimi kryesor publik të caktohet para gjykatës në të cilin duhet të ftohen palët si në vijim:

1. Prokurori Publik i Qarkut në Gjilan
I akuzuari Momcilo Trajkovic
Pala e dëmtuar, M [REDACTED] F [REDACTED], [REDACTED], Kamenicë
Pala e dëmtuar A [REDACTED] P [REDACTED]

Dëshmitarët:

B [REDACTED] H [REDACTED], ushtar i forcave Amerikane në Gjilan
Xh [REDACTED] K [REDACTED], rruga [REDACTED] nga Kamenica, dhe
A [REDACTED] P [REDACTED] nga fshati Tudjevce – Kamenicë e Kosovës

2. Si prova material duhet të prezantohen si në vijim:
Formulari i lirimit nr. 1137 të 27 qershor 1999 të lëshuar nga Qendra Mjekësore në Gjilan, Seksioni i Ortopedisë
Raporti mjekësor i lëshuar nga Qendra Mjekësore në Gjilan, Seksioni i Ortopedisë duhet të pranohet para gjykimit kryesor.
3. Pas shqyrtimit publik kryesor, dëgjimit të palëve në procedure penale, prezantimit të provave material dhe administrimit të tyre, propozoj që i akuzuari Momcilo Trajkovic të shpallet fajtor sipas akuzës dhe të dënohet me dënimin e duhur sipas ligjit.

Shpjegim

Provat, informatat dhe faktet e mbledhura dhe të vërtetuara gjatë hetimeve shërbyen për të provuar përtej dyshimit se i akuzuari në kohën, në vendin dhe në mënyrën e përshkruar në këtë aktakuzë, me dashje direkte ka kryer krimin sipas

nenit 30, par. 2 pika 3 1 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenin 19 të Ligjit Penal të Jugosllavisë dhe krimin e posedimit të paautorizuar të armëve apo materialit eksplozues sipas nenit 199, par. 3 në lidhje me par. 1 të Ligjit Penal të Kosovës.

Provat e mbledhura tregojnë se i akuzuari Momcilo Trajkovic, me 27 qershor 1999 me qëllim direkt tentoi të privoj nga jeta palën e dëmtuar M [REDACTED] F [REDACTED] dhe A [REDACTED] P [REDACTED] nga Kamenica, për shkaqe të urrejtjes nacionale për flamurin Shqiptar i cili ishte vendosur atë ditë në ndërtesën e Sekretariatit të Punëve të Brendshme nga A [REDACTED] P [REDACTED] dhe M [REDACTED] F [REDACTED]. Pasi që ka vërejtur flamurin, i akuzuari ka dalë nga banesa e tij dhe vazhdoi kah ballkoni në katin e tretë dhe ka shprehur zemërimin e tij. Pasi që ka folur, ai u kthye brenda dhe nga ballkoni ai ka shtënë 2 deri 3 të shtëna zjarri drejt palës së dëmtuar M [REDACTED] F [REDACTED] i cili ishte duke qëndruar jashtë ndërtesës në atë moment. I akuzuari ka shtënë nga ballkoni dhe dritaret e banesës së tij. Një e shtënë me plumb ka goditur palën e dëmtuar M [REDACTED] F [REDACTED] në gjurin e djathtë.

Me 7 shtator 1999, policia ushtarake e KFOR-it ka kontrolluar banesën e tij dhe ka konfiskuar një sasi municioni dhe granatat e dorës të përmendura më sipër si dhe një pushkë automatike AK-47 e cila me gjasë ishte përdorë me 27 qershor 1999 kur M [REDACTED] F [REDACTED] ishte lënduar.

I akuzuari Momcilo Trajkovic në mbrojtjen e tij plotësisht mohoi se ai me 27 qershor 1999 me dashje kishte tentuar të privoj nga jeta palën e dëmtuar M [REDACTED] F [REDACTED] nga Kamenica. Ai më tej deklaroi se nuk kishte shtënë as një të shtënë të vetme nga pushka automatike AK-47 nga banesa e tij afër ndërtesës së Sekretariatit dhe se ai nuk kishte vënë re flamurin Shqiptar të vendoset atë ditë.

Më tej ai konfirmoi se me 27 qershor 1999 ishte e diel dhe ai kishte qenë me familjen e tij duke kaluar vikendin në fshatin Carakovac në atë ditë apo jo. Ai ishte informuar mbi atë çka i ka ndodhur M [REDACTED] F [REDACTED] dhe A [REDACTED] P [REDACTED] kur ishte arrestuar dhe ishte sjellë në burgun e Gjilanit me 7 shtator 1999 dhe kur kishte dëgjuar lajmet ishte shokuar; ai saktësisht deklaroi se nuk ishte autor i krimit.

Sa i përket veprës tjetër penale, i pandehuri pretendonte se armët, pushka automatike, AK-47, dy granata dore dhe 300 plumba nuk i përkisnin atij por fqinjit të tij T [REDACTED], i cili i kishte sjellë ato nga banesa e tij te banesa e të pandehurit. Më tej, ai deklaroi se i kishte dorëzuar armët e tij te policia KFOR-it në fillim të qershorit 1999.

Faktet e dhëna nga i pandehuri nuk mund të konsiderohen si substanciale pasi që ato nuk korrespondojnë me realitetin së paku, dhe janë në kundërshtim me provat materiale, dëshmitë e dëshmitarëve të fituara gjatë rrjedhës së hetimeve, dhe për këtë arsye mbrojtja e tij duhet të refuzohet, me shpjegim se asnjë

dokument i vetëm në shkresat e lëndës nuk e konfirmon asnjë deklaratë të mbrojtjes së tij.

Pala e dëmtuar, M [REDACTED] F [REDACTED] dhe dëshmitari A [REDACTED] P [REDACTED] bindshëm përshkruan tmerrin që ata kaluan gjatë tentim-vrasjes me 27 qershor 1999 në Kamenicë para ndërtesës së Sekretariatit pasi që kanë vendosur flamurin Shqiptar. Papritmas, i akuzuari kishte dale në tarracë, dhe së pari iu drejtua atyre me fjalë ofenduese dhe në pesë minutat e ardhshëm ai ka shtënë me 2 deri 3 rafal të shkurtë nga pushka automatike dhe ka plagosur M [REDACTED] F [REDACTED].

Dëshmitari Xh [REDACTED] K [REDACTED] deklaroi se saktësisht me 27 qershor 1999, rreth 17:00 në Kamenicë, kur ai ishte në tarracë të ndërtesës në të cilën jetonte i akuzuari ai dëgjoi fjalët e cituara në fillim të kësaj aktakuze, plot zemërim e revoltë, dhe se pas pak kësaj ai dëgjoi një të shtënë nga arma automatike dhe menjëherë u kthye prapa në banesën e tij dhe të nesërmen mori vesh se çka ka ndodhur.

Dëshmitari B [REDACTED] H [REDACTED], një ushtar i trupave Amerikane bindshëm konfirmoi faktin se në ditën kritike 7 shtator 1999, i shoqëruar nga dy ushtar tjerë dhe një oficer të forcave ushtarake të rangut major, kishte kontrolluar banesën e të akuzuarit dhe të njëjtën ditë ata kishin konfiskuar pushkën automatike, AK-47, dy granata dore dhe 300 plumba.

Formulari i lirimit nr. 1137 i 27 qershorit 1999 i lëshuar nga Qendra Mjekësore në Gjilan në emër të M [REDACTED] F [REDACTED], tregon se ai ishte pranuar dhe hospitalizuar si rast emergjent për shkak të plagës nga arma, në gju.

Dëshmitë e dëshmitarëve dhe prezantimi i provave material si formular i lirimit nr. 1137, asi dhe burimet tjera bindshëm konfirmojnë përgjegjësinë e të akuzuarit i cili në kohën, vendin dhe mënyrën tanimë të përshkruar, me qëllim direkt kishte kryer dy vepra penale të vrasjes në tentativë sipas nenit 30 të Kodit Penal të Kosovës në lidhje me nenin 19 të Kodit Penal të Jugosllavisë dhe veprën penale të posedimit të paautorizuar të armëve apo materialit eksplozues sipas nenit 199, par. 3 në lidhje me par. 1 të Kodit Penal të Kosovës, ashtu që veprimet e tij reflektojnë të gjitha elementet inkriminuese të këtyre veprave penale, dhe mbi këto baza kërkoj nga kjo gjykatë që ta shpallë atë fajtor sipas akuzës dhe ta dënoj me dënimin e duhur sipas ligjit.

CECILIA TILLADA
Prokuror Ndërkombëtar